



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:242221

Datë: 04.09.2024

Numri i dokumentit: 06123609

C.nr.194/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, Kryetari i trupit gjykues-gjyqtari Leotrim Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses BKS, me seli ne Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson B.G., kundër të paditurit A.Xh., me vendbanim ne fshatin D, Komuna e V, me objekt kontekst rimbursim dëmi, jashtë seancës gjyqësore me datë 04.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

NË BAZË TË HEQJËS DORË NGA KËRKESPADIA

- I. REFUZOHET NË TËRËSI si e pabazuar kërkesëpadia e paditëses BKS, më të cilin ka kërkuar që të DETYROHET i padituri A.Xh. që në emër të aksidentit të datës 06.09.2016, në Vushtrri, ta rimbursoj paditësen BKS, në shumën prej 675.00 euro me kamatë ligjore sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, duke e llogaritur nga dita e padisë e deri në pagesën përfundimtare si dhe shpenzimet e procedurës, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A r s y e t i m

Paditësja BKS, me datë 03.05.2019, ka parashtruar padi pranë kësaj gjykate kundër te paditurit A.Xh., me objekt kontesti rimbursim dëmi.

Gjykata ka mbajtur seancën përgatitore me datë 03.09.2024, në të cilën ka marrë pjesë përfaqësuesja e paditëses B.G. dhe personalisht i padituri A.Xh..

Në këtë seancë, përfaqësuesja e paditëses ka deklaruar se paditësja heqë dorë nga kërkesëpadia ndaj të paditurit për shkak se në bazë të konfirmimit të Departamentit të Financave në kuadër të paditëses, është konfirmuar se për këtë çështje kontestimore ekziston një marrëveshje e lidhur në mes paditëses BKS dhe të paditurit A.Xh..

Në një situatë të tillë, gjykata duke u bazuar në nenin 149 paragrafi 1 të LPK-së në të cilin përcaktohet se *“Në qoftë se paditësi, deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadisë apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”* dhe paragrafin 2, të tij sipas të cilit thuhet se *“Për heqje dorë nga kërkesëpadia nuk nevojitet pëlqimi i palës së paditur”*, gjykata mori aktgjykim si në dispozitivin I, të këtij aktgjykimi me të cilin kërkesëpadia e paditëses është refuzuar në tërësi si e pabazuar.

Vendimin si në dispozitivin II, të këtij aktgjykimi gjykata e ka marrë duke u bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata në kuptim të nenit 160.6 të LPK-së, në arsyetimin e këtij aktgjykimi ka dhënë vetëm arsyet qe e justifikojnë marrjen e aktgjykimit për shkak të heqjes dorë nga kërkesëpadia.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:242221, C.nr.194/2019, me datë 04.09.2024

G j y q t a r i

Leotrim Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën dhe atë vetëm për arsyet e përcaktuara në nenin 181 par 2, të LPK-së.